

Faqja e Fakteve 2

...ndaj Australisë dhe popullit të saj...

Australia dhe populli i saj

Australia Shumëkulturore

Shoqëria jonë *shumëkulturore* përbëhet nga popuj që janë Australianët vendas, pasardhësit e kolonizatorëve të hershëm, dhe emigrantët e kohëve më të vona.

Australia është shumë krenare për përzierjen e pasur të kulturave, *cultural diversity* (larminë e kulturave) të saj. Politikat zyrtare të qeverisë përpiqen të bëjnë të sigurtë që ato që kanë lindur në Australi dhe ato që emigrojnë këtu kanë të njëjtën mundësi të marrin pjesë dhe të kontribuojnë në shoqërinë Australiane dhe të arrijnë potencialin e tyre të plotë si qytetarë.

Popujt Aboriginez dhe Torres Strait Islanders janë popuj *Indigeneous* (Vendas) të Australisë. Ato kanë zënë dhe janë kujdesur për këtë tokë për rreth 60 000 vjetë, me sistement e tyre të qeverisjes dhe të ligjit.

Më 1770 Kapiteni Cook (Kuk) e shkeli kontinentin e Australisë për Britaninë e Madhe. Të ardhurit e parë nga Britania arritën me 26 Janar 1788. Ato kanë qenë të dënuar (ose të burgosur) që u dërguan këtu si dënimpër krimet e tyre, detarë dhe ushtarë. Më shumë të dënuar dhe të lirë vazhduan të vijnë dhe që me 1859 u krijuan pesë koloni të reja përveç New South Wales (Wellsi i Ri i Jugut) - Tasmania, Western Australia (Australia e Perëndimit), South Australia (Australia e Jugut), Victoria dhe Queensland (Kuinsland).

Njezëz nga e gjithë bota emigruan në Australi dhe me 1861 popullsia e të ardhurve ishte rreth 1 200 000. Shumë emigrantë erdhën për të kërkuar ar pasi u zbulua për herë të parë me 1851, duke përfshirë një numra shumë të medhenj që erdhën nga Kina.

Në pjesën e dytë të shekullit të 20 mbi 5 000 000 njerëz emigruan në Australi. Sot të paktën 41 për qind e Australianëve janë ose të lindur jashtë shtetit ose janë fëmijë emigrantësh që kanë lindur jashtë shtetit.. Njerëz nga më shumë se 140 vende përbëjnë popullsinë Australiane që është rreth 19 milion.

Pajtimi

Pasi Britanikët u vendosën këtu nga fundi i shekullit 18 popujt Aboriginez dhe Torres Strait Islander pësuan një humbje dhe disavantazh të madh.

Shumë ranë viktime të sëmundjeve që sollën kolonizatorët; një numrit të madh të tyre iu morën tokat; dhe sistemet shoqërore dhe familjare u prishën dhe gati u shkatërruan plotësisht. Deri me 1960 ju është dhënë shumë pak njohje zyrtare kulturave dhe historisë

Aborigjineze dhe Torres Strait Islander ose të drejtave dhe përgjegjësi të tyre si qytetarë. Megjithëse *Akti i 1948 i Nationality dhe Citizenship* (Kombësisë dhe Nënshitetësisë) i dha nënshitetësinë të gjithë banorëve Australianë, deri shumë më vonë jo të gjithë Australianët Vendas arritën të gjithë të drejtat politike, shoqërore dhe ekonomike që Australianët e tjerë gëzonin.

Që me 1967 kur popujt Aborigjinez dhe Torres Strait Islander fituan të drejtën për të votuar në të gjithë zgjedhjet e Federatës, Shtetit dhe Territorit, Australianët Vendas kanë bërë shumë hapa drejt arritjes së drejtësisë dhe barazisë. Politikat qeveritare të vetëvendosjes kanë inkurajuar pjesmarrjen e popujve vendas në marrjen e vendimeve që kanë efekt në jetën e tyre.

Me 1991 Këshilli për Pajtimin e Aborigjinezëve u themelua për të përkrahur *Reconciliation* (Pajtimin) mes Australianëve Vendas dhe Australianëve të tjerë. P/er Këshillin qëllimi i Pajtimit është:

...një Australi e bashkuar që respekton tokën tonë; vlerat e trashëgimisë së Aborigjinezëve dhe të Torres Strait Islander; dhe siguron drejtësi dhe barazi për të gjithë.

Me 1996 Parlamenti Australian bëri një deklaratë të zotimit për të drejta të barabarta për të gjithë Australianët. Kjo përfshinte edhe një zotim mbi procesin e Pajtimit me Aborigjinezët dhe njerëzit e Torres Strait Island - në veçanti në kapërcimin e disavantazhit të tyre shoqëror dhe ekonomik..

Në Nëntor të vitit 2000 Qeveria Australiane dhe gjithë Qeveritë e Shteteve dhe Territorit u zotuan për të vazhduar mbështetjen e procesit të Pajtimit me anë të zvogëlimit të nivelit të disavantazhit që ndeshin Australianët Vendas.

Pajtimi është tani një çështje shumë e rëndësishme për komunitetin Australian. Ka shumë debate në lidhje me domethënien e Pajtimit, dhe se si ai mund të arrihet në Australi. Procesi drejt Pajtimit nuk është i lehtë, por Australia ka bërë disa hapa të rëndësishëm vitet e fundit. Arsimiti është një pjesë e rëndësishme e këtij procesi.

Gjuhët e Australisë

Anglishtja është gjuha kombëtare e Australisë, por një varietet i madh gjuhësh fliten. Këto përbëhen nga shumë gjuhë Vendas të Aborigjinezëve dhe njerëzve të Torres Strait Island, dhe gjuhët e atyre që kanë ardhë këtu nga vende të tjera. Politika e Qeverisë Australiane është që të gjithë Australianët duhet të lejohen të përdorin lirisht gjuhët e tyre përkrah gjuhës kombëtare.

Kontinenti i Australisë

Australia është ishulli më i madh në tokë dhe është vendi i gjashtë më i madh në botë. Ajo ka një popullsi relativisht të vogël në krahasim me madhësinë e saj - 19.1 milion njerëz me 1999. Shumica e njerëzve jetojnë në qytetet e mëdha dhe në qytetet e vogla rreth bregdetit, ose në fermat dhe qytetet bregdetare në drejtim të zonave bregdetare për arsye se brendësia është kryesisht shkretëtirë.

Klima ndryshon shumë. Është klimë tropikale në veriun e largët, e thatë dhe e nxehtë në qendër, dhe e butënë jug me reshje dëbore të rregulta në pjesë të New South Wales dhe Viktoria dhe në malet e Tasmanisë. Janari dhe Shkurti janë muajt më të nxehtë dhe Qershori e Korriku janë më të ftohtët.

Shtetet dhe Territoret Australiane

Australia përbëhet nga gjashtë Shtete dhe dy Territore. Secili ka një kryeqytet. Canberra (Kanbera) është kryeqyteti i Australisë.

Shteti	Kryeqyteti
Queensland (Kuinsland)	Brisbanë
New South Wales (Nju South Uells)	Sydney (Sidnei)
Victoria (Viktoria)	Melbourne (Meburni)
Tasmania	Hobart
South Australia (Sauth Australia)	Adelaide
Western Australia (Uestern Australia)	Perth
Territori	
Northern Territory (Nordhern Territori)	Darwin
Australian Capital Territory	Canberra

Simbolet Australiane

Simbolet zyrtare përdoren shpesh për të përfaqësuar Australinë. Simbolet kombëtare të Australisë janë:

Flamuri Australian

Flamuri ka tre elementa në një sfond blu të errët:

- ∄ e kuqja, e bardha dhe *Union Jack* (Shenja Kombëtare e Britanisë së Madhe) blu, që tregon lidjet historike të Australisë me Britaninë e Madhe
- ∄ *Southern Cross* (Kryqi i Jugut) i bardhë, një grup pesë yjesh që shihen në qiellin e hemisferës së jugut
- ∄ *Commonwealth Star* (Ylli i Komonvelthit) i bardhë (ose *Star of Federation*) (Ylli i Federatës), me shtatë pika që përfaqësojnë gjashtë Shtetet dhe kombinimin bashkë të Territoreve të Komonvelthit të Australisë.

Shpesh në Australi shihen dhe dy flamuj të tjerë: flamuri Aborigjinez dhe Flamuri i Torres Strait Islander.

Flamuri Aborigjinez

Flamuri Aborigjinez është i ndarë ndarë në dy pjesë të barabarta e zezë (sipër) dhe e kuqe (poshtë), me një rreth të verdhë në mes:

- € *black* (e zeza) simbolizon popollin Aborigjinez
- € *yellow* (e verdha) përfaqëson diellin
- € *red* (e kuqja) simbolizon tokën. (Ajo gjithashtu simbolizon edhe mineralin Okër që është një lloj boje e bërë nga dheu dhe që pëdoret nga Aborigjinezët nëpër ceremoni të ndryshme.)

Flamuri i Torres Strait Island

Veçori të flamurit të Torres Strait Island janë tri viza horizontale, e jeshile sipër dhe poshtë dhe blu në mes e ndarë nga viza tëholla të zeza. Një *dhari* (stoli për kokën) e bardhë qëndron në mes, me një yll me pesë cepa nën të:

- € *green* (jeshilja) simbolizon tokën
- € *blue* (bluja) simbolizon detin
- € *black lines* (vizat e zeza) përfaqësojnë njerëzit
- € *dhari* (stolia e kokës) është simbol i të gjithë njerëzve të Torres Strait Island
- € *five-pointed* (ylli me pesë cepa) përfaqëson grupet e ishullit, dhe është një simbol i rëndësishëm për udhëtimin në ujë të njerëzve të Torres Strait Island
- € *white* (e bardha) e yllit përfaqëson paqen.

Emblema

Emblema e Australisë përfaqëson identitetin dhe autoritetin e Komonvelthit të Australisë.

Ajo përbëhet nga tre pjesë:

- € një *shield* (mburojë) që përmban stemat e gjashtë shteteve Australiane (duke simbolizuar Federatën e Shteteve me 1901)

- € një *seven-pointed gold star* (yllë i artë me shtatë cepa) mbi një kurorë blu dhe të artë (cepat simbolizojnë gjashtë Shtetet dhe Territoret e kombinuara)
- € dy *native Australian animals* (kafshë Australiane vendase) - kanguri i kuq dhe struci i Australisë.

Ngjyrat kombëtare të Australisë

Me 19 Prill 1984 jeshilja dhe e verdha u bënë ngjyrat kombëtare të Australisë. Ato janë ngjyrat e skuadrave sportive të Australisë.

Lulja kombëtare e Australisë

Emblema zyrtare florale e Australisë (lulja) është Uatle e Artë. Uatle është një pemë e vogël me gjithë jeshilë të ndezur dhe me lule të verdhë të artë në pranverë.

Hymni Kombëtar

Të gjithë Australianët le të gëzohemi
Për arsye se ne jemi të ri dhe të lirë
Në sajë të përpjekjeve tona ne kemi dhe të artë dhe pasuri
Atdheu ynë është i rrethuar nga deti
Toka jonë ka shumë dhurata të natyrës
Të bukurisë së pasur dhe të rrallë
Në faqen e historisë, lejo çdo fazë
Advance Australia Fair
Kur të jemi në qejfë le të këdojmë
Advance Australia Fair

Këto janë vargjet e para të *Advance Australia Fair* që u bë Hymni Kombëtar i Australisë në 1984.